



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2019:266800

Datë: 31.12.2021

Numri i dokumentit: 02574873

**C.nr. 1017/19**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni civil,** përmes gjyqtarit Gazmend Ajvazi, me bashkëpunatorin profesional Baki Sylejmani, në çështjen juridike kontestimore të paditësit, B.H nga fshati Pozhoran, Komuan e Vitisë, kundër të paditurës Universiteti Kadri Zeka, me seli në Gjilan, të cilën e përfaqësojnë me autorizim Kushtrim Demi Zyrtar Ligjor i këtij faktulteti dhe Arben Sahiti profesor i këtij faktulteti, me objekt kontesti: anulim i vendimit për zgjedhjen e kandidatit, pas mbajtjes së seances per shqyrtimin kryesor e publik me datën 18.11.2021, mori ndërsa me datën 30 Dhjetor 2021 e përpiloi me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET** e pabazuar kërkesëpadia e paditësit B.H nga fshati Pozhoran, Komuna e Vitisë, e paraqitur kundër të paditurës Universitetit “Kadri Zeka”, me seli ne Gjilan, me të cilën ka kërkuar që të anulohet Vendimi 03/1710 i dt.13.09.2019 i të paditurës Universitetit “Kadri zeka” në Gjilan, për zgjedhjen e kandidatit L.D për mësimdhënës i lëndëve: Procedurë Adminsitrative, Sistem Elektorale, Klinika Juridike Adminsitrative, Zgjedhjet Lokale, Qeverisja Lokale dhe Ruajtje të Informacionit, si dhe të obligohet e paditura që paditësit t’ia kompensojë të ardhurat personale për këtë vend të punës sipas ekspertizës së ekspertit materialo-financiar, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

**Pretendimet e palëve ndërgjyqëse:**

Paditësi B.H nga fshati Pozhoran, Komuna e Vitisë, në këtë gjykatë më datë 15.11.2019, ka paraqitur padi kundër të paditurës Universiteti “Kadri Zeka”, me seli në Gjilan, me objekt kontesti: anulim i vendimit për zgjedhjen e kandidatit. Paditësi në padinë dhe kërkesepadinë e tij, ka theksuar se Unversiteti “Kadri Zeka” në Gjilan, ka shpallur konkurs publik në veb sajtin zyrtar për zgjedhjen e personelit akademik të rregullt. Ku në konkursin e shpallur për vendin e punës së mësimdhënësit është kërkuar titulli akademik Doktor Shkence, përvojë e punës dhe punime shkencore, për pozitën e mësimdhënësit, për lëndet: Procedurë Adminsitrative, Sistem Elektorale, Klinika Juridike Adminsitrative, Zgjedhjet Lokale, Qeverisja Lokale dhe Ruajtja Informacionit. Porse ishte njoftuar se në këtë vend pune është zgjedhur L.D nga Gjilani, për kundër faktit se dokumentacioni i paraqitur nga i përmenduri i njejt si dhe vlerësimi i

Komisionit Recensus, i njëjti ka tubuar 110.9 pikë, ndërsa paditësi 48.67 pikë, por se për kundër këtij fakti paditësi edhe pse me kushte më të mira nuk është zgjedhur. Komisioni Recensus me rastin e rekomandimit për zgjedhjen e kandidatit për pozitën e permendur, nuk ka bërë vlerësimin e duhur të përvojës së punës, punimeve dhe publikimeve shkencore dhe përgaditjes shkencore të kandidateve. Paditësi përveq që i ka plotësuar kriteret e konkursit dhe Statutit të Universitetit të paraqitur, ka përvojë pune më shumë se kandidati i përzgjedhur, ka publikime shkencore me impakt ndërkombëtar në përputhje me Udhëzimin Administrative të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nr.01/18, ka përvojë pune akademike si ligjerues në arsimin e lartë Kolgjin e “ Arbërit”, në Gjilan, 7 vite, e ku komisioni Recensus këtë përvojë nuk ia kishte njohur nga fakti se kinse është përvojë pune në Kolegje Unviersitare e jo në Universitete, çka është vlerësim tejet tendencioz dhe amatoresk, nga fakti se Ligji nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë n Republikën e Kosovës parasheh se institucionet e larta të arsimit konsidiorhen: Unviersitetet, Kolgjet Unvrsitare, Kolegjet, Instituet ejt, ashtu që përvoja e paditësit është e ngjashme me përvojat e kolegjeve të univertziteteve. Po ashtu arsyetimi tjetër i pa qëndrueshëm i Komisionit se paditësi ka fituar gradën shkencore në Universitetet Arsimore Private, bi ndesh me nenin 16 pika 7 e Ligjit të Përmendur, pasi se paditësi diplomën e doktoraturës e ka të nostrifikuar nga MASH-i. Paditësi ka një numër të konsiderueshëm të publikimeve shkencore, në revista prestigjioze të indeksuara në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr.01/2018 të MASHT-it. Paditësi për kundër kandidatit të zgjedhur ka të gjitha nivelet e studimeve në lëmin juridike, pra edhe studimet e doktoraturës në Fakultetin Juridik në profilin e Shkencave Adminsitrative, që i përgjigjet lëndëve në konkursin e shpallur nga e paditura. Ndërsa kandidati i zgjedhur në të dy nivelet e studimeve si ato në nivelin master edhe të doktoraturës nuk i kanë në fushën juridike, por në atë të komunikimit dhe të shkencave sociale. Andaj del se Komisioni ka bërë një mori shkeljesh nga fakti se kandidati i zgjedhur, studimet e doktoraturës nuk i ka kryer në Fakultetin Juridik, siq e konstaton komisioni në buletin por se këto studime i ka kryer në shkenca sociale gjegjësisht në Fakultetin e Komunikimit Publik të Inoformacionit, pranë Unviersiteety of LibRARY Studiers and Information Texhnologies (UNIBIT), po ashtu edhe studimet e nivelit master i ka kryer në Unvrsitetin e Evropës Juglindore, Fakulteti i Gjuhëve e Kulturave dhe Komunikimit, pra të dy nivelet nuk kanë të bëjnë me Fakultetin Juridike.

Andaj mbi këtë bazë i njëjti ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia e tij e paraqitur kunder të paditurës Universitetit “Kadri Zeka”, me seli ne Gjilan, dhe të anulohet vendimi për zgjedhjen e kandidatit nr.03/1710 i datës 13.09.2019 i të paditurit Universitetit “Kadri zeka” në Gjilan, për zgjedhjen e kandidatit L.D për mësimdhënës i lëndëve: Procedurë Adminsitrative, Sistem Elektorale, Klinika Juridike Adminsitrative, Zgjedhjet Lokale, Qeverisja Lokale dhe Ruajtjae Informacionit si dhe të obligohet e paditura që paditësit t’ia kompensojë të ardhurat personale për këtë vend të punës sipas ekspertizës së ekspertit materialo-financiar, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi më dt.03.12.2019 , të cilën e paditura e ka pranuar më 19.12.2019, e cila datë është konfirmuar përmes fletëkthesës e cila gjendet në shkresat e lëndës. Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurin për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore, që do ti ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, për mundësinë që gjykata të marrë aktvendim për shkak të mosbindjes.

I autorizuari në përgjigje në padi e ka kundërshtuar bazën juridike dhe faktike të padisë, duke e konsideruar këreksëpadinë si të pabazaur në ligjë dhe të paargumentuar duke kërkuar nga

gjykata që ta refuzojë të njëjtën si të pabazuar, si dhe të obligohet paditësja, që të paditurit tia kompensoj shpenzimet e procedurës gjyqësore në përputhje me TOAK-në.

Paditësi si në shqyrtimin përgatitor dhe ate kryesor, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë të paraqitur në këtë gjykatë, duke theksuar ai ka marrë pjesë në konkursin e UKZ-së, me numër 01375, të datës 25.03.2019, të cilin konkurs e ka shpallur departamenti i fakultetit Juridik ne UKZ, për lëndet Procedurë Administrative, Klinika Juridike Administrative, Zgjedhjet Lokale dhe Qeverisje Lokale, dhe kam konkuruar brenda afatit ligjor dhe sipas kushteve të UKZ, kam dorëzuar materialin komplet sipas kushteve të kërkuara, duke marrë parasysh faktin se konkursi është një institucion i cili ka për qëllim që t'iu mundësoj qytetareve të interesuar, që të jenë me të drejta të barabarta. Unë kam konkuru për lëndet e sipërmendura për arsye se mendoj se jam adekuat për lëndet përkatëse, pasi që i përkas kësaj fushe, fushë e cila ka mungesë kuadri në tërë Republikën e Kosovës. Fillimisht kur kam dorëzuar dokumentacionin tek referenti, ku emri i tij nuk më kujtohet dhe i njëjti më ka thënë se “kuadrin të cilit i përkisni ju ne vetëm e kemi në universitet”, cka konsideroj se kjo ka qenë një shkelje rreth barabartësisë të konkurentëve, pastaj kam thirrur dekanin e Fakultetit Juridik Sadik Haxhiu, dhe nga i njëjti kam marrë përgjegje se këto lëndë do t'ia japim kandidatit Liridon Dalipi, kjo ka ndodhur para se të mbyllet konkursi dhe para se të ipet intervista, dhe unë konsideroj se sipas dekanit konkurimi ka qenë vetëm qështje formale, dhe i cili veprim bie në kundërshtim me ligjin, me të drejtat të cilat mi garanton Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Unë i`u kam nënshtruar intervistës dhe posa jam ulur, jam sulmuar verbalisht nga antari i komisionit Urtak Hamiti si profesor i anglishtës, njëkohësisht edhe unë kam reaguar duke i thënë se unë këtu jamë në cilësi të kandidatit. Në intervist kanë marrë pjesë si intervistues profesor Zymri Elezi dhe profesor Berat Aqifi, unë kam marr pjesë në intervist por intervista nuk është zhvillu fare, për arsye se komisioni nuk e ka parashtruar asnjë pyetje, duke aluduar se do të kesh mirëkuptim për situatën. Vendimi i cili është nxjerrë nga komisioni i UKZ-së është aluduar në këto pika edhe ate: Përvoja e punës, kriter të cilin ai e ka plotësuar pasi që kam pasur përvoj pune 8 vite në kolegje, si profesor në të cilat kam treguar performancë të jashtëzakonshme, si dhe në insitucione tjera, ndërsa vërejtja nga komisioni ka qenë se unë nuk kam punuar në institucion publik arsimor, por kam punuar në institucione private, ku sipas ligjit institucionet private dhe ato publike të arsimist, para ligjit janë të barabarta, sepse që të dy këto institucione i nënshtrohen procesit të akreditimit. Vërejtje tjetër ka qenë se unë kam kryer studimet e doktoraturës në institucion privat, ndërsa kjo është totalisht e pa bazë për arsye se unë i kam kryer studimet në një Universitet ndërkombatarë me seli në Strugë, e i cili i ka plotësuar të gjitha ligjet ne fuqi sipas Republikës së Maqedonisë Veriore, duke ofruar studime në 5 pika të studimeve të doktoraturës. Vërejtje tjetër ka qenë punimet shkencore, ku sipas UKZ-së, ku thuhet se “Punimet e mia shkencore janë të publikuara në revista të dyshimta”, duke u thirrur në Udhëzimin Administrativ 1/18, kjo gjithashtu nuk qëndron pasi që unë punimin e drejta Administrative Europiane është i botuar në Gratz të Austrisë, ndërsa Udhëzimi Administrativ është aprovu në Janar të 2018, punimi i dytë është botuar E drejta Administrative në teritorin e Shqipërisë në platformën DOAJ, e cila parashihet sipas Udhëzimit Administrativ. Vërejtja tjetër ka të bëjë me atë se kandidati i zgjedhur Liridon Dalipi, nuk ka të bëjë me fushën e juridikut fare, për arsye se studimet master kandidati i ka të përfunduara në fushën e Komunikimit Masiv në Universitetin e Tetovës, ndërsa doktoraturën e ka të përfunduar në Bullgari në fushën sociale e jo juridike, për arsye se universiteti ne Bullgari nuk ofron fare studime në fushën e juridikut, dhe të gjitha lëndet e konkursit i takojnë fushës Adriministrative e jo sociale, dhe kandidati ne fjalë nuk mundet me akreditu asnjë program nga fusha juridike sepse nuk është adekuat. Gjithashtu kandidati në fjalë nuk mundet me qenë bartës i fushave juridike administrative sipas institucionit të akreditimit dhe gjithashtu si vërejtja e jona është edhe përbërja e komisionit, lidhur me ankesat ku në hyrje të vendimit

figurojnë emrat e komisionit dhe atë Refik Kryeziu, ndërsa në fund të vendimit ka nënshkruar edhe profesor Fejzullah Hasani. Ndërsa në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më datën 18.11.2021 ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe gjithashtu i propozoj gjykatës që si provë të administrohen edhe Udhëzimi Administrativ 2/2017, lidhur me Ligjin mbi Arsimin e Lartë, i cili u mundëson bartësve të arsimit të lartë dhe univerziteteve publike, që të jenë të barabartë në konkursin duke filluar nga arsimi pallafillor deri në univerzitet, dhe ky udhëzim administrativ i hudhë poshtë pretendimet e palës së paditur. Gjithashtu i propozojmë gjykatës në cilësi të provës të administrohet edhe deklarimi i ministrit Arsim Bajrami në vitin 2017, dhe nga një kopje u`a dorëzoi gjykatës dhe palës së paditur. I propozoj gjykatës që si provë të administroj edhe thirrjen e Universitetit “Kadri Zeka”, që mu ka dërguar mua e datës 17.05.2019. Kompetent është Agjencioni i Akreditimit për ta vlerësuar se në cilat lëndë unë jam më adekuat sesa kundër kandidati. Kërkoj gjykatës që e njejta të kërkoj raportin respektivisht procesverbalin e takimit të Komisionit për Verifikim, i cili më ka njohur punimin E Dretja Administrative Europiane.

Përfaqësuesi i parë i të paditurës Kushtrim Demai ka deklaruar, se e mbështesin plotësisht përgjegjen në padi, dhe gjithashtu e kundërshtojmë në disa pika deklarimin e paditësit, në fjalën e tij ku theksoj se të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit, në rastet kur i plotësojnë kushtet për tu zgjedhur profesor, dhe në këtë aspekt Universiteti i ka ndjekur të gjitha hapat ligjor për zbatimin e këtij parimi. Në pikën tjetër ku thekson se referenti i ka thënë se e kemi kuadrin, procedura e konkursit në universitet në të gjitha rastet shkruhet zgjedhje – rizgjedhje e personelit akademik, që lë të nënkupton se stafi që është i zgjedhur në një thirrje akademike ai ose mund të zgjedhet në thirrjen akademike ku është osë mund të ri zgjedhet. Profesori Urtak Hamiti, nuk është profesor i anglishtës, por është profesor Histori – Marëdhënie ndërkombëtare, duhet theksohet se nuk është komision intervistues , por është komision vlerësues – recensues, pala theksoj se gjithashtu ka bërë edhe kallzim penal në prokurori, kallxim i cili është hudhur poshtë nga ana e prokurorisë me numër PP.nr. 20062/19, i datës 05.05.2020. Gjithashtu edhe vendimet e komisionit të përmendura nga paditësi, mund të themi se ka qenë gabim teknik por në seancën e ardhshme gjykatës do t`ia sjellim vendimet edhe të komisionit të ankesave, dhe e kundërshtoj pretendimin se vendimet e komisionit janë të nënshkruara nga dekani. I ka i propozoj gjykatës që si provë të administrohen edhe udhëzimi administrativ 2/2017, lidhur me Lligjin mbi Arsimin e Lartë, i cili u mundëson bartësve të arsimit të lartë dhe univerziteteve publike, që të jenë të barabartë në konkursin duke filluar nga arsimi parafillor deri në univerzitet, dhe ky udhëzim administrativ i hudhë poshtë pretendimet e palës së paditur. Gjithashtu i ka propozuar gjykatës, që në cilësi të provës të administrohet edhe deklarimi i ministrit Arsim Bajrami në vitin 2017, thirrjen e Universitetit “Kadri Zeka”, që më është dërguar më datën 17.05.2019.

I autorizuari i dytë i të paditurës Arben Sahiti ka deklaruar, se në vijim do t`i paraqesin të gjitha provat faktike të bazuara ne ligj apo në rregullativën në fuqi ku përfshihet ligji mbi arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, 04L-037, Statuti i përkohshëm i UKZ-së, numër 03-118, Rregullorja e përzgjedhjeve të personelit akademik numër 01-315, e datës 18.03.2019, si dhe Udhëzimi administrativ i MASHT-it numër 01-2018, gjatë ekspozesë paditësi i paraqiti disa pretendime të cilat janë të pa qëndrueshme dhe nuk janë të bazuara ne rregullativën ligjore në fuqi, e cila i jep të drejtë një kandidati potencial të zgjidhet profesor asistent. Në pikën e parë të padisë që ka të bëjë me përvojën e punës e sipas rregullores për zgjedhjen e personelit akademik neni 13 pika 1.2 thuhet “ *Të jetë ose të ketë përvoje universitare për një periudhë jo me të shkurtër se 3 vite akademike*”, statuti i përkohshëm i UKZ-së, në nenin 157 pika 1.5 thuhet si në vijim “ *Të ketë së paki 3 vite përvoj pune në procesin mësimor në universitet*”, në anen tjetër ligji mbi arsimin e lartë neni 16, pika 5 thotë kështu “ *Vetëm bartësit publik të arsimit të lartë mund të ofrojnë programe studime që qojnë në kualifikimin e një mësimdhënësi për tu punësuar në një shkollë*”, kështu që në të gjithë rregullativën ligjore kërkohet përvoja

universitare e jo në kolegje private apo në institute të ndryshme. Padiësi B.H studimet bachelor i ka të kryera në kolegjin Gjilani, ndërsa masterin e ka të përfunduar në kolegjin Iliria, kolegji i cili është i mbyllur. Në bazë të studimeve themelore dhe master paditësi nuk ka kualifikim që të punësohet në asnjë institucion ku mund ta ushtroj profesionin e mësim dhënësit, e cka do të thotë se që nga shkolla fillore e deri në universitet, gjithashtu edhe përvojën universitare të cilën e ka 7 vite që e ka paraqit nuk është përvojë universitare por është përvojë nga një kolegji privat. Në pikën e dytë ku është fjala të punimet shkencore ku sipas rregullorës për zgjedhjen e personelit akademik neni 13, pika 3.2 e specifikon qarte se për ta fituar titullin profesor asistent kandidati duhet të ketë së paku një prej artikujve të jetë botuar në revista shkencore ndërkombëtare, më ipakt faktor sipas udhëzimit administrativ 01-2018, e që sipas rregulloreve në fuqi kandidati nuk ka asnjë punim shkencor të publikuar në revista ndërkombëtare ashtu siq kërkohet sipas rregullorës në fuqi. Punimet që janë prezentuar nga paditësi nuk janë të publikuara në Austri por janë të publikuara përmes një insituti i cili quhet Insituti për të Drejtën Private Komerciale dhe të Konkurrencës, dhe pagesat bëhen në emer të profesorit Endri Papajoqi. Sipas neve kjo revistë është fiktive, e që në rastin e zgjedhjeve të profesorëve, këto publikime në revista të dyshimta apo fiktive nuk merren parasysh. Po ashtu ka shtuar se pretendimi lidhur me profesorin L.D se i njëjti nuk është i fushës adekuate për lëndët në të cilat është zgjedhur, dekani i fakultetit Juridik Sadik Haxhiu, i ka dërguar një shkresë qendres kombëtare për njohje të diplomave dhe barasvlerë ku ata i kanë kthyer përgjigje dhe ku thotë se profesori L.D është i fushës për lëndët e zgjedhura, dhe i vetmi institucion i cili bënë njohjen e diplomave dhe barasvlerën e tyre e që emertohet NARIC Kosova. Padiësi në të gjitha instancat në UKZ, ka marrë përgjegje negative. I ka propozojmë gjykatës që në shqyrtimin kryesor të administrohen të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Ndërsa në fjalën përfundimtare të njëjtit kanë deklaruar se mbetet pranë përgjigjes në padi, dkelarimve dhe thënieve në seancat për shqyrtimet gjyqësore si dhe parashtrësive të dorëzuara nga ana e të paditurit, duke vlerësuar se pas adminsitrimin të provave u vërtetua bindshëm se nuk deli themelësia e kërkesëpadiës së paditesit. Të njëjtit kanë shtuar se pretendimin se I njëjti ka punime të publikuara të cilat nuk janë marrë parasysh e paditura k dëshmuar se nuk qëndron ngase këto duhet të jenë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, duke përfshirë Statutin e Përkohshëm të Unversitetit Kadri Zeka edhe ate neni 157 pika 1.1, Rregulloren për Zgjedhjen e Personelit Akademik në Unversitetin Kadri Zeka në Gjilan neni 13 pika 3.2, Liogjin për Arsimin e Lartë në Repzublikën e Kosovës neni 26 pika 7, Udhëzimin Adminsitrativ nr.01/2018- Parimet e njohjes së Platformave dhe Revistave Ndërkombëtare me Recesncion aty sqarohet edhe më tutje, konkretisht te neni 3 pika 5 dhe neni 3 pika 6, përderisa paditësi nuk i plotëson këto kritere. Po ashtu ka shtuar se pretendimin se kandidati i përzgjedhur nuk përkon me lëndët e caktuara për të ligjëruar, e paditura i ka hedhur posht paditesit me konfirmimin nga Qendra Kombëtare për Njohje dhe Barasvlerë, e cila ka dëshmuar se kandidati i përzgjedhur ka prapavijën akademike të duhur për të ligjëruar lëndët e caktuara me konkurs e cila prove është adminsitruar edhe në gjykatës dhe në fund të njëjtit i kanë propozuar gjykatës që kërkesëpadija e paditesit Besim Halini nga fshati Pozhoran, komuna e Vitisë të refuzohet si e pabazuar.

### **Provat e administruara në shqyrtimin kryesor:**

Gjykata për të vepruar drejtë dhe për t'i vërtetuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse si dhe për ta vërtetuar drejtë gjendjen faktike në këtë çështje kontesitmore ka administruar dhe vlerësuar këto prova materiale: Vendimi i UKZ-së, me numër 01/2014, i datës 17.10.2019; Aktvendimi i UKZ-së me numër 05/2003, i datës 14.10.2019; Vendimi i UKZ-së, me numër 03/1710, i datës 13.09.2019; Konkursi i UKZ-së, me numër reference 01/375, i datës 25.03.2019, Referati i komisionit vlerësues për zgjedhjen e personelit akademik, i datës 24.05.2019, Udhëzimi administrativ, numër 01/2018 – parimet e njohjes së platformave, dhe revistave ndërkombëtare

me recension, Diploma e Universitetit i Ndërkombëtar në Strugë, për doktor të shkencave juridike, e datës 26.12.2013 – Diploma me numër 0006-1-1-1, Vendimi mbi nostrifikimin me numër reference 6-1715, i datës 06.11.2018, Punimi në gjuhën angleze me numër, ISSN 2410-3918, mars 2019, Ligji mbi arsimin e lartë, me numër 04L-037, Publikimi i punimit shkencor në revista ndërkombëtare, me numër ISSN 2519-1284, janar 2017, Ankesa e datës 20.06.2019, e organit të shkallës së dytë për ankesa të UKZ-së, Statuti i përkohshëm i Universitetit Publik të Gjilanit, me numër 03-118, i datës 06.03.2018, Rregullorja për zgjedhjen e personelit akademik, të UKZ-së me nuëmr reference 01/315, e datës 18.03.2019, Komunikimi nëpërmjet emailit elektronik me institutin në Shqipëri, të datës 02.10.2021, Shkresa të insitutit ku bënë thirje për botime në gjuhën shqipe, të datës 27 maj 2021, Punimi i botuar i vitit 2017, në gjuhën angleze, Udhëzimi Administrativ i MASHT-it, numër 02/2017, për vlefshmërinë e programeve studimore të bartësve privat të Arsimit të Lartë, Njoftimi i ministrit të arsimit Arsim Bajrami i dhënë në një medium elektronik, pa date, Njoftimi – Ftesë për ligjeratë prezentuese, e datës 17.05.2019, Vendimi i Komisionit për Ankesa i Këshillit të Fakultetit Juridik, i UKZ i datës 12.06.2019, Vendimi për Akreditimin e Elaboratit për organizimin e ciklit të dretë të studimeve të doktoraturës në drejtësi në Fakultetin Juridik të Universitetit Ndërkombëtar të Strugës me numër 03,82/1 i datës 26.03.2013, Kontrata e punës, në emër të Liridon Dalipit, vendi i punës Asistent, e cila kontratë është për periudhën kohore prej 01.10.2013 deri në 30.06.2014, Një USB lidhur me një emision të një mediumi të Shqipërisë Top Chanel, Përgjegjja në kërkesën e Z. Sadik Haxhiu dekan i Fakultetit Juridik

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar, dhe rrjedhimisht edhe e refuzoi, pasi që:

Me Vendimin e UKZ-së, me numër 01/2014, i datës 17.10.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se i është refuzuar aneksa kandidatit Dr.sc.Besim Halimi, për tu zgjedhur në thirrjen akademike profesor asistent, në Fakultetin Juridike në UKZ-së.

Me Aktvendimin e UKZ-së me numër 05/2003, i datës 14.10.2019, gjykata provoi faktin se është refuzuar si e pabazuar ankesa e kandidatit Dr.sc.Besim Halimit, për moszgjedhjen e tij, në thirrjen akademik profesor asistent për lëndët Porcedurë administrative, Sistemet elektorale, Klinika juridike administrative, Zgjedhejet lokale, Qeverisja Lokale dhe Ruajatja e informacionit.

Me Vendimin e UKZ-së, me numër 03/1710, i datës 13.09.2019, gjykata provoi faktin se në bazë të ktij njoftimi Dr.L.D është zgjedhur si kandidati më i sukseshëm, në konkursin për zgjedhjen e personlet akademik të datës 26.03.2019 në Fakultetin Juridik.

Me Konkursin ei UKZ-së, me numër reference 01/375, i datës 25.03.2019, gjykata provoi faktin se e paditura ka shpallur konkurs për mësimdhënës në Fakultetin Juridike edhe atë, një mësimdhënës për lëndët: Porcedurë administrative, Sistemet elektorale, Klinika juridike administrative, Zgjedhejet lokale, Qeverisja Lokale dhe Ruajatja e informacionit.

Nga Referati i komisionit vlerësues për zgjedhjen e personelit akademik, i datës 24.05.2019, gjykata provoi faktin se paditësi B.H është vlerësuar me 48,67 pikës ndërsa kundër kadidati L.D me 110.9 pikë.

Nga Udhëzimi administrativ, numër 01/2018, gjykata provoi faktin se këto janë përcaktuar kriteret – parimet e njohjës së platformave, dhe revistave ndërkombëtare me recension.

Nga Diploma e Universitetit i Ndërkombëtar në Strugë, gjykata vërtetoi faktin se i njëjti ka doktoruar në shkencat juridike më datën 26.12.2013 – Diploma me numër 0006-1-1-1.

Nga Statuti i përkohshëm i Universitetit Publik të Gjilanit, me numër 03-118, i datës 06.03.2018, gjykata provoi faktin se ky statut ka hyrë në fuqi më datën 12.08.2013.

Nga Rregullorja për zgjedhjen e personelit akademik, të UKZ-së me numër reference 01/315, e datës 18.03.2019, gjykata provoi faktin se në këtë rregullore janë përcaktuar kushtet e përgjithshme për zgjedhjen e rizgjedhjen e personelit akademik, në marrëdhënien e rregullt të punës të bazuara në Ligjin për arsimin e lartë dhe Statutin e Unviersitetit si dhe kriteret e veqanta për zgjedhjen e personelit akademik të nxjerra nga Senati i Unviersitetit.

Në bazë të Komunikimit nëpërmjet emailit elektronik me institutin në Shqipëri, të datës 02.10.2021, gjykata vërtetoi faktin se kundërkandidati L.D Profesor ass. në Fakultetin Juridik në Unviersitetin “Kadri Zeka”, në Gjilan ka komunikuar me profesor Endri Papajorgji në Shqipëri.

Nga Udhëzimi Administrativ i MASHT-it, numër 02/2017, gjykata provoi faktin se sipas këtij udhëzimi është bërë vlerfshmëria e programeve studimore të bartësve privat të Arsimit të Lartë.

Njoftimi i ministrit të arsimit Arsim Bajrami i dhënë në një medium elektronik, pa date, gjykata provoi faktin në këtë email shkuran se ky është Udhëzim Adminsitrativ me të cilin ish ministri Arsim Bajrami favorizoi kolegjet private (Dokument).

Nga Njoftimi – Ftesë për ligjeratë prezentuese, gjykata provoi faktin se më datën 17.05.2019 Zyra e personelit kanjoftuar që komisioni pas shqyrtimi dokumentacioneve për pozitën 12 një mësimdhënës për lëndët: Procedurë administrative, Sistemet elektorale, Klinika Juridike adminsitrative, Zgjedhjet Lokale, Ruajtja e Informacionit janë ftuar për ligjeratë prezentuese që është mbajtur më datën 20.05.2019 prej orës 11:30-12:00 h, në sallën A34 në UKZ. në Gjilan.

### **Baza ligjore:**

Sipas nenit 8 parag. 2 të Ligjit nr.03/L-212 i Punës (ne tekstin e metejme: LP) është paraparë se: *“Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi, ashtu siç parashihet me këtë ligj dhe aktet tjera në fuqi”*. Me nenin 10 parag. 1 te LP, eshte parapare se:”Kontrata e punes lidhet ne forme te shkruar nga punedhenesi dhe i punesuari.

Po ashtu, sipas nenit 2 parag.1, nenparag.1.1. te Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, eshte parapare se: . Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë, me kushtet për qasje në punësim, vetëpunësim dhe punësimin në profesion, përfshirë këtu kushtet e punësimit, kriteret e përzgjedhjes, pa marrë parasysh aktivitetin në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, përfshirë avancimet”.

Sipas nenit 2 te Ligjit për Procedurën Kontestimore (ne tekstin e metejme: LPK), eshte percaktuar qarte se: *“Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”,* ndersa me nenin 7 te po ketij ligji, eshte percaktuar se: *”Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Gjykata është e autorizuar ti vërtetojë edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur si dhe ti marrë edhe provat të cilat palët*

*nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuar në nenin 3 paragrafi 3 të këtij ligji), në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe. Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen”.*

Sipas nenit 13 te Ligji për Arsimin e Lartë, është përcaktuar se: *“Bartësit e licencuar të arsimit të lartë kanë autonominë dhe lirinë akademike”*, ndërsa sipas Statutit të Përkohshëm të Universitetit Publik të Gjilanit, “Kadri Zeka”, me nenin 153, parag.1 te këtij Statuti është përcaktuar se: *“I gjithë personeli akademik gjatë perudhës së udhëhequr nga organet e përkohshme pas përfundimit të procedurave të rregullta do të emërohet nga Rektori dhe Këshilli i PTH në bashkëpunim me MASHT, sipas vendimit të Senatit i bazuar në propozimin e këshillit të njësisë akademike”*, sipas parag.2 te këtij Statuti është përcaktuar se: *“Nëse propozimi refuzohet, ai i kthehet për rishqyrtim këshillit të njësisë akademike”*, sipas parag. 3 te po këtij Statuti është përcaktuar se: *“Nëse këshilli i njësisë akademike edhe pas rishqyrtimit sjellë të njëjtin propozim, Senati në bashkëpunim me Rektoren dhe Këshillin merr vendim përfundimtar”*. Po ashtu, me nenin 156, parag.1, pika 1.2 te po këtij Statuti është përcaktuar se: *“Për titullin e profesorit të asocuar kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte: Të ketë një numër të zgjedhur të monografive, publikimeve në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, me së paku 3 punime kryesore të publikuara në revista ndërkombëtare”*.

Sipas Rregullores për Zgjedhjen e Personelit Akademik në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan, Ref.nr.01/315 të datës 18.03.2019, perkatesisht me nenin 8, parag.7 te kesaj Rregullore, është përcaktuar se: *“Komisioni recensues ia dorezon raportin njesise akademike, brenda 30 diteve, pas miratimit te vendimit per formimin e komisioneve vleresuese”*, ndersa sipas parag.15 te po kesaj Rregullore parashihet se: *“Keshilli i Fakultetit e miraton apo e refuzon propozimin e komisionit dhe e dergon ne Komision te Studimeve te Universitetit”*, pastaj sipas parag.19 te Rregullores është përcaktuar se: *“Pesembedhjet (15) dite pas publikimit te vendimit te Senatit dhe njoftimit te kandidateve, mund te ushtrohet ankese (shkalla e dyte) ndaj vendimeve te Senatit”*; sipas parag. 20 te Rregullores, është përcaktuar se: *“Komisioni i ankesave i Universitetit dote shqyrtoje ankesat brenda tridhjetete (30) diteve dhe i ben nje raport Senatit, ne te cilin miraton, refuzon apo hedh pretendimet e kandidateve”*, gjë të cilën e paditura e ka bërë në afatet e parapara ligjore.

## **Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës**

Në këtë çështje kontestimore nuk ishte kontestues fakti se paditësi tek e paditura kishte, konkuruar në pozitën e profesorit në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan, që ishte publikuar ueb sajdin uytare për zgjedhjen e personelti të rregullt akadmik dhe atë në pozitën e mësimdhënësit për lëndët Procedurë Adminsitrative, Sistem Elektoral, Klinike Juridike Adminsitrative, Zgjedhjet Loikale, Qeverisje Lokale dhe Ruajtja e Informacionit. Po ashtu në këtë çështje nuk ishte kontestues as fakti se Universiteti “Kadri Zeka” kishte shpallur konkurs për një mësimdhënësi ku ishte kërkuar titulli akademik Doktor Shkence , përvoja e punës dhe punimet shkencore, po ashtu një gjë e tillë vërtetohet nga Konkursi me numër REF.nr.01/375, i datës 25.03.2019, e ne te cilin konkurs ka aplikuar edhe paditësi per poziten e pretenduar. Po ashtu, ne mes te paleve nuk ishte kontestues fakti se paditësi nga Komisionit vlerësues ishte vlerësuar me 48,67 pikë ndërsa kundërkandidati kishte akumulaur 110,9 pikë.

Kontestuese në këtë çështje ishte nëse Senati i Universitetit “Kadri Zeka”, kishte vepruar në kundërshtim me vlerësimin e Komisionit Recensues për zgjedhjen e Personelit Akademik, pasi që paditësi nuk ishte pranuar në pozitën e mësimdhënësit për lëndët Procedurë Adminsitrative, Sistem Elektoral, Klinike Juridike Adminsitrative, Zgjedhjet Loikale, Qeverisje Lokale dhe



Ruajtja e Informacionit. por që në këtë pozitë ishte pranuar kundërkandidati z. Liridon Dalipi. Po ashtu pretendimi i paditësit se i njejtë ka punime të publikuar të cilat nuk janë marrë parasysh, e paditura ka dëshmuar se nuk qëndron ngase të njëjta duhet të jenë në përputhje me korinuzën ligjore në fuqi duke përfshirë Statutin e Përkohshëm të Universitetit “Kadri Zeka”, edhe ate nenin 157 pika 1.2, Rregulloren për Zgjidhjen e Personelit Akademik, Rregulloren për Zgjidhjen e Personelit Akademik në Universitetin Kadri Zeka në Gjilan neni 13 pika 3.2, Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës neni 26 pika 7, Udhëzimin Administrativ nr.01/2018- Parimet e njohjes së Platformave dhe Revistave Ndërkombëtare me Recensionin aty sqarohet edhe më tutje, konkretisht te neni 3 pika 5 dhe neni 3 pika 6, përderisa paditesi nuk i plotëson këto kritere.

Gjykata pas shqyrtimit dhe analizimit të provave të administruara, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, për shkak se paditesi përmes padise ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia e tij dhe të anulohet vendimi nr.03/1710 i dt.13.09.2019, e të obligohet e paditura që paditësit t’ia kompensoj të ardhurat personale, për këtë vend të punë sipas ekspertizës së ekspertit materialo financiare, ngase kandidati i cili pretendon të zgjidhet profesor i faktuletit padyshim vërtetohet se i njejtë në çdo, aspekt i ka plotësuar të gjitha kushtet e konkursit, më mirë se kandidati i zgjedhur Liridon Dalipi. Po ashtu Këshilli i Fakultetit i ka dërguar në Senat edhe recensionin pozitiv për z.Fadil Osmanin dhe recensionin negativ për z.Nijazi Halili për vendimarrje përfundimtare dhe pas debatimit lidhur me recensionin pozitiv dhe negativ ka marr vendim përfundimtar, ku ka zgjedhur z.Fadil Osmanin, profesor asistent edhe duke u bazuar në nenin 168 të Statutit të Universitetit Kadri Zeka në Gjilan, ku Senati merr vendim përfundimtar. Po ashtu edhe rregullorja për procedurën përzgjedhëse, lidhur me emërimin riemërimin dhe avancimin e personelit akademik, në Universitetin publik “Kadri Zeka” në Gjilan të dt.12.06.2020, neni 14 paragrafi 20 thotë se Vendimi i senatit është përfundimtar.

Gjithashtu gjykata në marrjen e këtij vendimi meritor u bazua në nenin 7.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) ku është e paraparë se *“palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, dhe nenin 319 I LPK-së par.1 I cili thotë se *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*, dhe në nenin 322 par.1 i cili thotë se *“Në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e proves”* dhe 2 të LPK-së, i cili thotë se *“Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”*, e ku në rastin konkret paditesi nuk ka mundur që të argumentojë pretendimet e tija dhe për arsyet e lartëcekura gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka bërë administrimin dhe vlerësimin edhe të provave të tjera materiale, mirëpo vlerësoi se të njëjtat nuk janë relevante dhe janë pa ndikim në zgjidhjen e kësaj çështje juridike.

Gjykata vendosi që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta gjyqësore, bazuar në nenin 450 të LPK, ku parashihet se secila palë paraprakisht vet i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta e po ashtu duke u nisur nga fakti që asnjëra palë ndërgjyqëse nuk i ka kërkuar në mënyrë të specifikuar ashtu siq parashihet në nenin 463.1 të LPK-së.

Ngase u tha më lartë, në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE GJILAN**  
**C.nr.1017/19, me datë 30.12. 2021**

Numri i lëndës: 2019:266800  
Datë: 31.12.2021  
Numri i dokumentit: 02574873

**Gjyqtari,  
Gazmend Ajvazi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë, në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, ankesa ushtrohet nëpërmjet kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme.